



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 1464/ prot.  
4

Tiranë më 19.11.2018

**VENDIM**

Nr. 67, datë 19.11.2018

**MBI**

**ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", neneve 77-112 të Ligjit Nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Shkolla "*Nobel*",

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit Nr. 240 datë 01.10.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Shkolla "*Nobel*", me objekt:

- Zbatimi i Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit, Shkolla "*Nobel*".

Në funksion të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", Shkolla "*Nobel*", është kontrollues i cili mbledh dhe përpunon të dhëna personale të kategorive "*punonjës*", "*nxënës*" dhe "*prindër*". Kontrolluesi Shkolla "*Nobel*", është subjekt juridik me NIPT: K72118016I.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit Shkolla "*Nobel*", konstaton se:

1. Kontrolluesi Shkolla "*Nobel*", nuk ka kryer detyrimin për "*Njoftim*" pranë Zyrës së Komisionerit mbi përpunimin e të dhënave personale në zbatim të neneve 21 dhe 22

të ligjit. Gjatë zhvillimit të inspektimit përfaqësuesi i kontrolluesit paraqiti një "Formular Njoftimi" të plotësuar në datën 11.06.2015, por nga kontrolli që u bë në protokollin e Zyrës së Komisioneri dhe në Regjistrin Elektronik të kontrolluesve nuk rezultoi që një formular i tillë të jetë dorëzuar nga ana e kontrolluesit. Në datën 13.11.2018 gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, Kontrolluesi pretendoi se në vitin 2015 ka dorëzuar "Formularin e Njoftimit" dorazi në ambientet e Zyrës së Komisionerit dhe se e kishte protokolluar, por nuk paraqiti asnjë numër protokolli apo provë tjetër që të vërtetonte kryerjen e këtij detyrimi.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i cili parashikon: "Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës...".

2. Ambientet e brendshme në të cilat kontrolluesi ushtron aktivitet, janë të mbikëqyrura nëpërmjet sistemit të video-survejm (CCTV). Konstatohet që kontrolluesi ka vendosur tabelat informuese me qëllim informimin e subjekteve, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejm (CCTV), por këto tabela nuk janë sipas standardit të përcaktuar në Udhëzimit Nr.3 datë 05.03.2010 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".
3. Kontrolluesi nuk ka vendosur politikën e privatësisë në portalin zyrtar [www.shkollanobel.com](http://www.shkollanobel.com), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Informacioni i publikuar në "Politikat e Privatësisë", duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Në datën 13.11.2018 gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore Kontrolluesi pretendon se në adresën zyrtare të shkollës "Nobel" janë afishuar politikën e privatësisë përpara zhvillimit të kontrollit. Nga fotografimi i faqes zyrtare të kontrolluesit [www.shkollanobel.com](http://www.shkollanobel.com) në datën 17.10.2018 nuk rezultoi të jetë publikuar një rubrikë për politikën e privatësisë.

"1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij...etj".

4. Grupi i kontrollit konstatoi se kontrolluesi mban dosjet e punëmarrësve të larguar nga puna si dhe aplikimet për punësim për një periudhë të pacaktuar. Në datën

13.11.2018 gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, Kontrolluesi u shpreh se: *"Shkolla "Nobel" ka rregulla të qarta për administrimin e dosjeve dhe se afati i ruajtjes së dokumentave të portofolit profesional është 3 vjet"*. Në mbështetje të këtij argumenti, kontrolluesi paraqiti urdhrin e brendshëm Nr.778 prot. datë 22.09.2015 për kriteret dhe afatet e ruajtjes së dosjeve të stafit të larguar si dhe një deklaratë pëlqimi të një nënpunësi të larguar. Nga provat e administruara nga grupi i kontrollit gjatë inspektimit nuk rezulton që këto dokumenta të jenë dorëzuar. Një fakt i tillë vërtetohet dhe nga procesverbali i hetimit.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin (datë 17.10.2018), të cilin përfaqësuesi i kontrolluesit e ka nënshkruar duke paraqitur komentin: *"S'jam dakord me konstatimet"*.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"*, kontrolluesi Shkolla "Nobel" është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore pranë ambjenteve të Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesi është paraqitur në seancë dhe ka dokumentuar rikuperimin e shkeljeve administrative të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë tij. Në shkresat e paraqitura, kontrolluesi shprehet se ka plotësuar:

1. Pretendime me shkrim mbi rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë kontrollit;
2. Formular Njoftimi i datës 11.06.2015;
3. Modelin e tabelës informuese;
4. Rregulloren *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*;
5. Model Deklaratë Konfidencialiteti;
6. Urdhër i brendshëm mbi kriteret e ruajtjes së dosjeve;
7. Model Deklaratë Pëlqimi.

Zyra e Komisionerit e vlerëson këtë qëndrim dhe reflektim të menjëhershëm, por kjo nuk e përjashton kontrolluesin nga përgjegjësia administrative. Shkeljet e konstatuara janë të një natyre serioze, pasi ato lidhen ngushtë me garantimin e parimeve në përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, saktësinë që duhet të kenë të dhënat dhe kur është e nevojshme korrigjimin e tyre.

Si përfundim shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në lidhje me mosinformimin e subjekteve mbi përpunimin e të dhënave në portalin e kontrolluesit si dhe mos *"Njoftimin"* pranë Zyrës së Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave personale, në kuptim të nenit 39, pika 1, gërmat *"b"* dhe *"d"* të Ligjit Nr.9887/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

- *"Kontrolluesit, që nuk përmbushin, detyrimin për të informuar, të përcaktuara në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me nga 10.000 deri në 300.000 leke"*
- *"Kontrolluesit, që nuk përmbushin, detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit të nenit 21 të këtij ligji, dënohen me nga 10.000 deri në 500.000 leke"*

Në bazë të nenit 39/2 të Ligjit Nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin se Kontrolluesi Shkolla "Nobel", është angazhuar në mënyrë të menjëhershme në rikuperimin e shkeljeve të konstatuar nga grupi i kontrollit. Ky fakt ka ndikuar në përcaktimin e vlerës së masës së gjobës referuar dispozitave të Ligjit Nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

### PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 21, 29, 30, 39 pika 1, gërmat "b" dhe "d", si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

### V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit Shkolla "Nobel", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
2. Dënimin e kontrolluesit Shkolla "Nobel", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 19.11.2018.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

